



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Department of Slobodnih Profesija-  
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.07/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në idhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.634/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuar nga „Petrit Reqica -Udhëheqës i Divizionit për Mbikqyrjen e Ligjshmërisë së Profesioneve të Lira,dhe Përmbaruesi Privat, me datë 14.06.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-07/2022 i datës 07.03.2022, si i pabazuar.

**II. Përmbaruesi Privat**, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në „nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore , P. nr. 634/2014.

## A r s y e t i m

Me datën 10.12.2021,pala ankuese \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_, në Divizionin e Minsitrisë së Drejtësisë që ka të bëjë me Mbikqyrje të Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, ka parashtruar kërkesë duke potencuar se përmbaruesi privat \_\_\_\_\_ ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore duke marrë pjesë si përmbarues në çështjen ku ka vendosur si gjyqëtar në të njejtën lëndë në Gjykatën Themelore në \_\_\_\_\_. Pala ankuese në kërkesën e parashtruar ka kërkuar që të pezullohen veprimet përmbarimore të ndërmarra nga përmbaruesi duke njoftuar se kundër përmbaruesit ka parashtruar edhe padi për anulim të veprimeve përmbarimore të ndërmarra nga përmbaruesi privat me kërkesë që përmbaruesi të shpallet përgjegjës për këto veprime.

Divizioni për Mbrojtje të Ligjshmërisë ka bërë inspektimin në këtë rast dhe në raportin e tyre të datës 28.02.2022,ka konstatuar se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, pasi ka ndërmarrë veprime si gjyqëtar i Gjykatës Themelore në Gjakovë edhe si përmbarues privat në të njejtën lëndë,duke pretenduar se në bazë të paraprafit të parë të nenit 325 të LPP-së dhe pikës d të nenit 67 të LPK-së, i njejt i ka bërë shkelje duke vepruar në kundërshtim me këto dispozita. I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndermirren masa ndaj përmbaruesi privat.

Me datën 07.03.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore fillimisht ka shfaqur vërejtjet e tij në raportin e inspektimit të kryer nga ana e divizionit përkatës,duke potencuar se divizioni për inspektim ka pasur vërejtje në bashkëpunimin me përmbaruesin sa i përket dorëzimit të shkresave,por përmbaruesi e ka njoftuar divizionin se lënda është voluminoze dhe është në gjykatë për shqyrtim të kërkesës së palës debitore lidhur me kërkesën e tyre për përjashtim të përmbaruesit privat dhe nuk është e vërtetë se përmbaruesi ka sjellur disa shkresa ,pasi përmbaruesi ka dorëzuar shkresat që ka pasur në dispozicion dhe ka njoftuar edhe divizionin lidhur me pengesat në sistemin elektronik për menaxhimin e lëndëve. Kjo nga shkakun se lënda ishte voluminoze dhe e kishte të pamundur sigurimin komplet të dosjes,duke sygjerruar që divizioni mund t' i drejtohet vetë gjykatës për sigurimin e të gjithë dosjes , pasi e njejt është në gjykatë.



Sa i përket pretendimit për shkelje pasi ka vepruar edhe si gjyqëtar edhe si përmbarues në të njejtën lëndë, përmbaruesi ka deklaruar se derisa kjo lëndë ka qenë në gjykatë ,përmbarimin në këtë lëndë e ka lejuar gjyqtari tjetër ,konkretisht gjyqtari Agim Muhaxhiri në vitin 2010,ku përmbaruesi nuk ka qenë fare në gjykatë ,pastaj në këtë lëndë lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitorët me dt.20.04.2012 është vendosur nga gjyqtarja Afijete Sada Glllogjani,kështuqë pas emërimit të tij si gjyqtar, aktvendimi për ekzekutim në këtë lëndë, ka qenë i formës së prerë dhe prej asaj kohe lënda i është dorëzuar për veprime tjera. Pala ankuese poashtu ka parashtruar kërkesë për përjashtim të gjyqëtarit ,por që kërkesa e tyre është refuzuar.

Lënda nga gjykata tek përmbaruesi është transferuar me kërkesë të kreditorit me datën 29.10.2014. Pala debitore ka parashtruar kërkesë për përjashtim të përmbaruesit , pasi përmbaruesi ka ndërmarrë veprime në këtë lëndë. Në deklarin e tij në kërkesën për përjashtim si përmbarues,i njejtë ka deklaruar se ia le në dorë gjykatës të vendos duke mos u deklaruar fare për përjashtimin e tij.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në PPP.nr.119/16,dt.29.07.2016 është refuzuar kërkesa për përjashtim të përmbaruesit.Pas kësaj përmbaruesi ka ndërmarrë veprimet e tij ku në urdhërin e shitjes pala debitore ka parashtruar ankesë . Në mesin e pretendimeve tjera ka qenë edhe pretendimi sa i përket veprimit të përmbaruesit edhe në gjykatë edhe si përmbarues për këtë rast, ankesë kjo e cila është refuzuar nga Gjykata e Apelit dhe urdhëri për shitje është i plotëfuqishëm.

Pasi ankesa i është refuzuar debitorëve me kërkesë të kreditorit , procedura ka vazhduar sa i përket zbrazjes së paluajtshmërisë ,por përsëri pala ka parashtruar kërkesë për përjashtim, por me vendimin e gjykatës me datën 25.02.2022,është refuzuar përsëri kërkesa për përjashtim të përmbaruesit.

Derisa lënda ka qenë ende në gjykatë,përmbaruesi ka kuptuar që ndaj tij pala ankuese ka parashtruar edhe padi për anulim të veprimeve përmbarimore dhe kallëzim penal ndaj përmbaruesit dhe përmbaruesi duke pasur parasysh rrethanat e reja sikurse kallëzimi penal ndaj tij dhe padia parashtruar në gjykata,ka deponuar në gjykatë deklaratën që kërkesa për përjashtim të përmbaruesit të aprovohet dhe gjykata me vendimin e saj të datës 12.04.2022, ka aprovuar kërkesën për përjashtim të përmbaruesit në këtë lëndë.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar.

Poashtu edhe pala ankuese si dhe përmbarruesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, të paraqitura me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbarruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërin nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së, sepse përmbarruesi privat ka ndërmarrë veprime përmbarrimore në rastin konkret pasi rasti i është transferuar nga gjykata. Komisioni poashtu vlerëson se përmbarruesi ka qenë i obliguar që të veproj bazuar në vendimin e gjykatës me të cilin është refuzuar përjashtimi i tij dhe fakti i ,mospërjashtimit të tij nga gjykata , e ka obliguar të njëjtin që të veproj në këtë rast edhe pas krijimit të rrethanave tjera sikurse parashtrimi i padisë kundër përmbarruesit privat dhe kallëzimit penal ndaj përmbarruesit për pretendimet se ka bërë shkelje ligjore duke pretenduar se ka konsumuar edhe vepër penale, përmbarruesi me të drejtë ka kërkuar edhe vet përjashtimin ,me ç'rast në këtë fazë është aprovuar kërkesa e tij dhe palës për përjashtim të përmbarruesit privat dhe veprimet tjera në këtë rast nuk janë ndërmarrë pas vendimit të gjykatës për përjashtim.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr.07/2022 datë 14.06.2022**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.